

Instrument Evropian për demokraci
dhe të drejta të njeriut i Unionit Evropian

NËPËRMJET AKTIVIZMIT TË TË RINJVE DREJT BASHKËJETESËS SË DALLIMEVE NË BASHKËSI

Përvoja pozitive dhe praktika të mira për tejkalim të paragjykitimeve etnike dhe stereotipave të rinia e shkollave të mesme dhe krijimi i hapësirave të sigurta për ndërveprim, njohje të ndërsjellë dhe aktivizëm të përbashkët



Programi i bashkëpunimit dhe të bashkuarimit Evropian



aktivizmi i bashkuar



MULTIKULTURA

NËPËRMJET AKTIVIZMIT TË TË RINJVE DREJT BASHKËJETESËS SË DALLIMEVE NË BASHKËSI

Përvoja pozitive dhe praktika të mira për tejkalim të paragjykimeve etnike dhe stereotipave të rinia e shkollave të mesme dhe krijimi i hapësirave të sigurta për ndërveprim, njohje të ndërsjellë dhe aktivizëm të përbashkët

Instrument Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut i Unionit Evropian

Ky publikim është përpiluar me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e veçantë e IQF ANTIKO dhe Multukultura dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet se i shpreh qëndrimet Unionit Evropian

Projekti është financuar nga Unioni Evropian

Botues:

Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

“Vukovarska” 23/1-2

1000 Shkup

Tel. ++389(0)2 2 614 641; ++389 (0)2 2 61 130

e-mail: antico@t-home.mk, contact@antiko.org.mk

www.antiko.org.mk

Titulli: Nëpërmjet aktivizmit të të rinjve drejt bashkëjetesës së dallimeve në bashkësi: përvoja pozitive dhe praktika të mira për tejkallim të paragjyqimeve etnike dhe stereotipave të rinia e shkollave të mesme dhe krijimi i hapësirave të sigurta për ndërveprim, njohje të ndërsjellë dhe aktivizëm të përbashkët

Redaktor:

Gjyner Nebiu

Autorë:

Danica Jovanova

Gjyner Nebiu

Aleksandra Jovevska

Mislime Osmani

Dizajni dhe përgatitja teknike:

Propoint

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
“Св. Климент Охридски”, Скопје

316.723-021.463:316.346.32-053.6(497.7)

NËPËRMJET aktivizmit të të rinjve drejt bashkëjetesës së dallimeve në bashkësi : përvoja pozitive dhe praktika të mira për tejkallim të paragjyqimeve etnike dhe stereotipave të rinia e shkollave të mesme dhe krijimi i hapësirave të sigurta për ndërveprim, njohje të ndërsjellë dhe aktivizëm të përbashkët / [autorë Danica Jovanova ... и др.]. - Shkup : Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO, 2013. - 28 стр. : илустр. ; 21 см

Автори: Danica Jovanova, Gjyner Nebiu, Aleksandra Jovevska, Mislime Osmani

ISBN 978-9989-2824-8-5


1. Jovanova, Danica [автор]

а) Мултикултурализам - Младински активизам - Македонија
COBISS.MK-ID 95095818



PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	4
2. Unioni Evropian	5
3. Për projektin	6
4. Aktivitetet e realizuara.....	8
- Trajnim për trajnues për multikulturë.....	8
- Cikël punëtorish në shkollat e mesme	9
- Shkolla verore për multikulturë.....	10
- Përkrahje mentori	13
- Aksione publike në bashkësi	14
- Realizimi i aktiviteteve në kuadër të aksioneve publike në bashkësi	15
- Konferenca nacionale	23
5. Produkte, rezultate dhe ndikimi i projektit.....	25



Hyrje

Multikultura dhe adresimi i marrëdhënieve ndëretnike në procesin e arsimit paraqesin bazë për mirëkuptim të ndërsjellë dhe ndërtim të shoqërisë me kohezion e cila i kultivon vlerat e vërteta – paqen, respektin, tolerancën, jodhunën dhe dialogun mes dallueshmërive. Aspiratat për anëtarësim në UE janë të përbashkëta për të gjithë qytetarët në shtetin tonë, megjithatë ata së pari duhet të mësojnë t'i kuptojnë, pranojnë dhe respektojnë dallimet në vendin e tyre, që të mund të bashkëngjiten me familjen multikulturore dhe multietnike të Unionit Evropian.

Zhvillimi i shoqërisë multikulturore është i mundur nëpërmjet ballafaqimit dhe mënjanimi të arsyeve për sjellje të dhunshme, zgjidhje të problemeve dhe sfidave, me qëllim që të ndërtohet hapësirë e lirë dhe e sigurt për zhvillimin e individëve dhe grupeve të mbështetura në bashkëpunim, lidhje dhe dialog. Në këtë kontekst, rinia e shkollave të mesme është potencial i cili meriton kujdes dhe i cili duhet të orientohet në kohë të duhur drejt vlerave të vërteta.

Arsyet për shfaqjen e tensioneve ndëretnike në institucionet arsimore, posaçërisht në shkollat e mesme në vendin tonë, Iniciativa qytetare e femrave (IQF) ANTIKO i ka identifikuar përgjatë procesit të realizimit të aktiviteteve me popullsinë e re në fushën e promovimit të kulturës së

paqes dhe jodhunës, ndërsa edhe ndjekjen e kontekstit në të cilin jetojmë, ngjarjet dhe ndodhitë aktuale, si edhe në bazë të studimeve të caktuara dhe hulumtimeve nga ana e organizatave joqeveritare dhe institucioneve relevante. Në përgjithësi, komunikimi i dobët, mosnjohja e kulturave dhe vlerave të ndryshme, barrierave gjuhësore, shkalla e pamjaftueshme e tolerancës dhe dialogut, si edhe ekzistimi i paragjytimeve etnike dhe stereotipave janë disa nga arsyet e mosmarrëveshjeve mes të rinjve dhe shfaqjes së konflikteve. Në mjediset multietnike rrallë mund të hasen hapësira të përbashkëta për ndërveprim ndëretnik të të rinjve, hapësirave për komunikim dhe bashkëpunim të hapur. Si individë të cilët janë në zhvillim dhe janë në fazën e ndërtimit të identitetit vetjak, ata paraqesin kategori të ndjeshme të qytetarëve të cilët janë të ekspozuar ndaj ndikimeve negative dhe nëse nuk punohet në mënyrë të vazhdueshme me ta, mund të manipulohen për arritjen e efekteve të padëshirueshme. Prandaj, është posaçërisht e rëndësishme si do t'u qasemi të rinjve dhe si do të mësojnë t'i kuptojnë dhe respektojnë vlerat e llojllojshmërisë kulturore, por me këtë rast edhe vetë të jenë krijues dhe zbatues të aksioneve të cilat ofrojnë dhe promovojnë paqe dhe bashkëjetesë.

Gjatë realizimit të programit “Të rinjtë dhe multikulturalizmi” në vitet e kaluara IQF ANTIKO e hetoi nevojën për marrjen e hapave të vazhdueshëm dhe ambiciozë të cilat çojnë drejt krijimit të vlerave afatgjate të popullsisë e re, të cilët edhe në të ardhmen do t’i kultivojnë dhe praktikojnë. U mbajtën tre Shkolla për Multikulturë, është publikuar Doracaku për Multikulturë, është realizuar konferenca me temë “Si ta ndjejnë të rinjtë shpirtin e multikulturës”, ndërsa nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të vullnetarëve të rinj në organizatat lokale anëtare të rrjetit të ANTIKO-s, të rinjtë i ndërtonin kapacitetet e tyre për aktivizmin qytetar. Të kënaqur nga të arriturat dhe të

motivuar që me përmbajtje ta pasurojmë dhe zhvillojmë programin, por edhe të japim kontributin tonë në mobilizimin e të rinjve për promovim të qëllimeve pozitive dhe idealeve për paqe, tolerancë, barazi, dinjitet, të drejta të njeriut, aktivizëm qytetar dhe demokraci, u qasëm drejt realizimit të projektit “Nëpërmjet aktivizmit të të rinjve drejt bashkëjetesës së dallimeve në bashkësi”. Praktika pozitive e nismës së këtillë është kalimi nga teoria në praktikë, pavarësi në krijimin dhe zbatimin e aksioneve, motivimin e kreativitetit, iniciativës dhe motivimin e të rinjve.

Projekti: “Nëpërmjet aktivizmit të të rinjve drejt bashkëjetesës së dallimeve në bashkësi” është financuar dhe përkrahur nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut

UNIONI EVROPIAN

Unioni Evropian ka 28 vende anëtare të cilat gjatë kohës së zgjerimit pesëdhjetëvjeçar, gradualisht i kanë lidhur resurset e veta dhe kanë ndërtuar zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, me këtë rast duke e kultivuar shumëllojshmërinë kulturore, tolerancën dhe liritë individuale.

Unioni Evropian është përkushtuar në ndarjen e të arritave dhe vlerave të veta me vendet dhe popujt jashtë kufijve të saj.

Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut (EIDHR) është njëri nga programet më të vjetra të Unionit Evropian dhe është i destinuar për përkrahje të zhvillimit dhe forcim të të drejtave të njeriut dhe demokracisë nëpër botë.



Për projektin

Kjo broshurë është përpiluar si rezultat i projektit “Nëpërmjet aktivizmit të të rinjve drejt bashkëjetesës së dallimeve në bashkësi” që në periudhën prej 16.12.2013 – 17.01.2014 e realizojnë IQF ANTIKO, si bartës i projektit dhe organizata partner Multikultura nga Tetova, ndërsa me përkrahje të Unionit Evropian në kuadër të Instrumentit Evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut (EIDHR).

Ideja e projektit është në drejtim të arritjes së kohezionit mes grupeve rinore në bashkësi dhe animimin e tyre të përbashkët si indikator për tejkalimin e problemeve të karakterit multi-etnik dhe bashkëjetesës mes të rinjve. Kapacitetet lokale rinore janë faktor i rëndësishëm për iniciimin e ndryshimeve pozitive me efekt të mëtutjeshëm të multiplikimit, si në arsim, ashtu edhe në bashkësi në përgjithësi. Përgjithësisht, në tërë procesin e aksionit njëra nga detyrat themelore ishte të krijohet atmosferë konstruktive mes anëtarëve të grupeve dhe të stimulohet dhe inkurajohet iniciativa dhe motivimi i tyre. Të rinjtë, bashkërisht punuan në identifikimin e problemeve në bashkësi, sugjerorin zgjidhje dhe realizuan aktivitete, që kontribuoi të ndjejnë përgjegjësi dhe obligim, ta ndërtojnë zhvillimin e tyre personal dhe identitetin, dhe të kuptojnë se ajo që e bëjnë është e dobishme dhe pozitive, për vetë ata dhe për shoqërinë.



Qëllimi i projektit:

Kontribut ndaj rritjes së rrolit të aktivizmit të të rinjve në promovimin dhe zbatimin e vlerave të multikulturës dhe bashkëjetesës në bashkësi.

Qëllimet specifike:

1. Forcimi i kapaciteteve rinore për zbatim praktik dhe zhvillim të multikulturës në bashkësitë lokale;
 2. Rritja e dukshmërisë së iniciativave multietnike të të rinjve në nivel lokal – zbatimi në bashkësi.
 3. Përmirësimi i bashkëpunimit mes subjekteve relevante, grupeve joformale rinore dhe palëve të prekura në raport me zbatimin e modaliteteve dhe praktikave më të mira për zhvillim të multikulturës te të rinjtë.
-

Grupet synuese

Në realizimin e projektit ishin të përfshirë:

- 16 studentë/absolventë të Fakulteteve të shkencave pedagogjike dhe shoqërore nga Shkupi dhe Tetova, pjesëmarrës të TOT në tema nga multukultura – PEER edukatorë dhe realizues të punëtorive në shkollat e mesme;
- 200 nxënës të shkollave të mesme nga viti I deri në vitin III të përkatësive të ndryshme etnike nga shkollat e mesme multietnike “Arseni Jovkov” dhe “Zdravko Cvektovski” nga Shkupi dhe “Gjoce Stojčevski” dhe “8 Shtatori” nga Tetova.
- 8 profesorë nga shkollat e mesme në rolin e mentorëve të nxënësve, përkrahës në realizimin e aktiviteteve dhe organizatorë të punëtorive.

Aktivitetet të realizuara

Trajnim për trajnues për multikulturë

Nëpërmjet pjesëmarrjes në Trajnimin për trajnues (cikël prej dy trajnimeve nga 14 deri 17 dhe nga 29 deri 31 mars 2013) 16 studentë/absolventë nga fakultetet e shkencave pedagogjike dhe shoqërore nga Shkupi dhe Tetova, i forcuan kapacitetet e tyre për multikulturë dhe shkathësi të lehtësuesit për zbatim të trajnimeve me të rinjtë, me qëllim që bashkërisht të gjejnë modalitete përkatëse për zbatimin e tyre.

Ky ekip i të PEER trajnuesve të rinj nga disa bashkësi lokale, të cilat kishin dëshirë të madhe dhe entuziazëm t'i avancojnë dituritë e tyre dhe shkathësisë dhe të vazhdojnë t'i shumëfishojnë të njëjtat nëpër shkolla, sektorin qytetar dhe në bashkësitë e tyre lokale, paraqet resurs të qëndrueshëm dhe potencial me të cilin sigurohet vazhdimësia e mëtejshme e aktiviteteve. Duke e pasur parasysh përcaktimin e tyre profesional si punëtorë të ardhshëm (të mundshëm) arsimorë, mendojmë se kontributi i tyre do të jetë me rëndësi të madhe edhe për procesin arsimor ku në të ardhmen një pjesë e tyre do të angazhohen në mënyrë profesionale. Të udhëhequr nga trajnuesit me përvojë, pjesëmarrësit në TOT kishin mundësi në mënyrë të suksesshme t'i përvetësojnë shkathësitë e lehtësuesit dhe metodologjinë për realizim të punës, si edhe zonat tematike të lidhura me

multikulturën – komunikimin pa dhunë dhe transformimin e konflikteve, paragjykimet dhe stereotipat, ndërmjetësimi, negocimi dhe sjellja e vendimeve me konsensus, puna ekipore, aktivizmi qytetar, zbatimi i aksioneve publike në bashkësi dhe të ngjashme. Trajnimi i tyre mes tjerash përfshinte edhe punë praktike: planifikim të pavarur të sesioneve, përgatitje të prezantimeve dhe ushtrimeve praktike, realizim të sesioneve punuese, xhirim me kamerë, dhënie të vlerësimit kthyes nga ana trajnuesve



dhe grupit. Metodatat dhe teknikat e zbatuara interaktive të TOT, stimuluan ndërveprim mes pjesëmarrësve, zbatim të përvojave, por edhe lidhjen, rrjetëzimin dhe njohjen e tyre të ndërsjellë – me vlerat e ndryshme tradicionale dhe kulturore, traditat, bindjet religjioze etj. Kjo kontribuoi ndaj kompaktësisë së grupit, miqësisë të reja, shkëmbimit të ideve dhe propozimeve kreative për aktivitete dhe nisma të reja, por edhe tejkalimin e disa paragjykitimeve dhe stereotipave ekzistues për njëri-tjetrin.



Cikli i punës në shkollat e mesme në Shkup dhe Tetovë – shumëfishimi i diturive

Grupi i trajnuesve të rinj të shpërndarë në 8 ekipe, në periudhën prill-maj 2013, nëpërmjet mbajtjes së 32 punësive, njohuritë e mara i shumëfishoi në 4 shkollat e mesme multietnike.

Në punëtoritë morën pjesë 200 nxënës nga katër shkollat e mesme. Temat të cilat i përpunoi çdo grup i nxënësve në kuadër të ciklit prej 4 punësive kishin të bëjnë me shoqërinë multikulturore, shkathhtësitë e komunikimit dhe komunikimin pa dhunë, ballafaqimin me konfliktet dhe aktivizmin publik në bashkësi.

Trajnuesit e kishin parasysh moshën e pjesëmarrësve dhe pikërisht për shkak të specifikave të tyre dhe me qëllim që ta ruajnë vëmendjen dhe interesin e tyre, dizajnuan metodologji e cila e siguron animimin e tyre të vazhdueshëm gjatë kohës së punësive – dinamikën grupore, ushtrime individuale dhe grupore, debate. Çdonjëri prej tyre kishte mundësi t'i tregojë vështirëtimet dhe qëndrimet e tija në lidhje me temat, të flasë për problemet dhe barrierat me të cilat ballafaqohen të rinjtë e bashkësive të ndryshme etnike dhe të japë propozime vetjake për tejkalimin e tyre. Nga ana e trajnuesve posaçërisht u theksuan tre përbërësit e rëndësishëm për aktivizëm të mëtejshëm të nxënësve: zhvillimi personal, puna ekipore dhe inkuadrimi/iniciativa në bashkësi. Konsultimet me profesorët/mentorët në

procesin e realizimit të aktiviteteve paraqisnin segment të rëndësishëm në sigurimin e përfshirjes të kuadrit arsimor.

Nxënësit e shkollave të mesme treguan shkallë të lartë të pjekurisë, qëndrime dhe vështirime personale në raport me gjendjet ekzistuese në fushën e ndërveprimit multikulturor në arsim. Me këtë rast, shprehën gatishmëri të mësojnë më tepër me nxënësin tjetër të bashkësisë tjetër etnike si parakusht themelor për mirëkuptim më të mirë, komunikim të papenguar, tejkallim të stereotipave dhe paragjytimeve dhe respekt të ndërsjellë. Në fund, megjithatë u pajtuan se problemet dhe interesat e tyre janë të njëjtë ose të ngjashëm, si edhe të të gjithë të rinjve dhe se bashkërisht mund të bëjnë shumë me qëllim që ta përparojnë ardhmërinë e tyre dhe ta rrisin rolin e të rinjve në proceset e vendosjes dhe krijimit të strategjive dhe programeve të cilat e prekin popullsinë e re. Me këtë ata do të jenë pjesëmarrës aktivë dhe do të japin kontribut për zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqen.

Shkolla verore për multikulturë

Ohër, 15.06.-20.06.2013

Në “Shkollën verore” morën pjesë 43 pjesëmarrës, prej të cilëve 24 nxënës të shkollave të mesme nga katër shkollat e përfshira nga Shkupi dhe Tetova, profesorët/mentorët e tyre, por edhe një pjesë e ekipit të trajnuesve të rinj të cilët kishin mundësi që nëpërmjet asistencës në realizimin e sesioneve të caktuara të vazhdojnë t'i avancojnë shkathtësitë e tyre dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në krijimin e aksioneve publike me nxënësit e shkollave të mesme.

Mbajtja e “Shkollës verore” për nxënësit paraqiste sfidë dhe motivim plotësues që të arrijnë sukses në qëllimin si forcë lëvizëse, iniciues dhe krijues të aktiviteteve në shkollat e tyre dhe bashkësi, të cilat janë të destinuara drejt ndërtimit të besimit, ndërveprimit ndëretnik dhe mirëkuptimit. U zgjodhën nxënës solidë, inventivë, të cilët treguan aktivitet në punëtoritë dhe në aktivitetet jashtë arsimore, nxënës të cilët besonin në vete dhe kishin interes dhe dëshirë të vazhdojnë në zbatimin e multikulturës, dhe të përfshijnë edhe persona të tjerë të rinj. Gjatë kohës së “Shkollës verore” ata kishin mundësi t'i thellojnë dhe t'i shpërblejnë dituritë dhe shkathtësitë e tyre, të shoqërohen dhe nëpërmjet përmbajtjeve me

karakter kreativ dhe zbatimës të njihen mes veti, por edhe të diskutojnë hapur dhe të debatojnë rreth problemeve dhe arsyeve të cilat janë burim i tensioneve dhe konflikteve, duke u munduar t'i ofrojnë qëndrimet e veta dhe të gjejnë zgjidhje praktike për tejkalimin ose eliminimin e tyre.

Miqësitë e reja dhe relacionet e fuqishme të cilat i krijuan gjatë periudhës gjashtëditore të mësimit të përbashkët, punës aktive, shoqërimit dhe punës, janë vetëm indikator se është e nevojshme të krijohen hapësira të përbashkëta dhe të sigurta për ndërveprim ndëretnik, vullnet të mirë, vetëdijesim të lartë dhe



dëshirë për komunikim – në mënyrë aktive të dëgjohe-mi, të mundohemi të kuptojmë dhe t'i mënjanojmë barrierat të cilat i kemi krijuar paraprakisht në kokat tona nën ndikimin e mjedisit, ambientit, familjes ose faktorëve të tjerë. Nëse këta të rinj, treguan se kjo është e mundshme, atëherë ekziston optimizmi se shoqëria jonë ka kapacitet dhe me sukses mund të integrohet dhe fokusohet në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe paqes.

Nxënësit e shkollave të mesme me kujdes dhe interes të veçantë u angazhuan rreth përvetësimit të përmbajtjeve të caktuara tematike. Posaçërisht ishin aktive në realizimin e ushtrimeve praktike dhe diskutimeve, ndërsa shkathtësitë dhe teknikat për shprehje kreative dhe artistike të ideve të tyre i mësuan me përkrahjen e trajnuesve dhe vullnetarëve të Forumit të arsimit rinor. Në raport me temën e gjetjes së fondeve nxënësit e shkollave të mesme u njohën me metodat e mbledhjes së mjeteve nga burimet lokale, duke e pasur parasysh se është shumë e rëndësishme për aktivizmin e tyre të mëtutjeshëm. Nëpërmjet kësaj tematike, pjesëmarrësit morën njohuri për mënyrat me të cilat mund të organizojnë lloje të ndryshme të ngjarjeve në bashkësi nëpërmjet sigurimit të mjeteve financiare për zbatimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve (humanitare) dhe aktivitete të dobishme shoqërore, që të mundën atë që e kanë mësuar ta zbatojnë në praktikë. Pjesëmarrësit e rinj bashkërisht

me pjesëmarrësit e tjerë organizuan aukcion, në hotelin ku mysafirëve të pranishëm u ofronin suvenire të cilat i kishin bërë vetë ose i kishin blerë. Me këtë aksion ata mbledhën 8.300 denarë. Ata vendosën kontakte dhe bashkëpunim edhe me Kryqin e Kuq të Ohrit dhe ia dhuruan Simonës nëntëvjeçare, e cila është e verbër dhe e cila jeton me nënën e saj që kujdeset vetë për të dhe dy motrat më të vjetra. “Shkollës verore” ishte mundësi e mirë që të rinjtë të punojnë në zhvillimin e ideve të tyre në aksione publike, të cilat më pas do t'i zbatojnë në bashkësi. Bashkë me profesorët e tyre/mentorët dhe lehtësuesit e rinj, ndërsa me përkrahje të trajnuesve dhe ekipeve të IQF ANTIKO dhe Multikultultura, të angazhuar punuan bile edhe në orët e pasdites dhe përgatitën 4 draft plane për aksione publike. Në planet i theksuan problemet me të cilat u ballafaquan ata në shkollat dhe bashkësitë në jetën e tyre të përditshme. I përcaktuan qëllimet dhe aktivitetet me të cilat do të ndikojnë në zgjidhjen e tyre. I caktuan personat përgjegjës, resurset e nevojshme dhe mjetet dhe indikatorët, respektivisht treguesit e suksesit. Si plotësim, pas mbarimit të “Shkollës verore” planet u finalizuan nëpërmjet mbledhjeve të vazhdueshme punuese dhe kontakteve me palët tjera të përfshira dhe aktorët në bashkësi, pas çka u qas drejt realizimit të tyre. Ky aktivitet për nxënësit e shkollave të mesme, por edhe për pjesëmarrësit e tjerë paraqiste një përvojë të re

dhe të dobishme. Kënaqësia e tyre dhe përshtypjet në raport me qasjen dhe metodën e zbatuar ishin të mëdha pikërisht për shkak të faktit që e lehtësojnë përvetësimin e materies, japin mundësi për ndërveprim dhe afim, zbatim të teorisë në praktikë dhe krijojnë relacione të afërta të ndërsjella për bashkëpunim, rrjetëzim dhe shkëmbim të përvojave dhe veprim të përbashkët në zgjidhjen e problemeve, identifikimin e sfidave dhe nevojave të bashkësive.



Përkrahja e mentorit

Duke e pasur parasysh se puna e mentorit është segment i rëndësishëm gjatë procesit të ndjekjes se si të rinjtë i zbatojnë në praktikë dituritë e përvetësuar, në zbulimin dhe shfrytëzimin e potencialit të të rinjve, inicimin e aktivizmit dhe lidhjen e grupeve rinore me bashkëqeverisjen lokale dhe organizatat tjera qytetare, gjatë realizimit të projektit u promovua dhe u praktikua mësimi nëpërmjet mentorit edhe atë në disa nivele. Trajnuesit/ekspertë të TOT, pas mbarimit të trajnimit nëpërmjet punës së vazhdueshme të mentorit i përkrahnin trajnerët e rinj, me qëllim që të marrin përvojë më të madhe dhe të vazhdojnë të ndërtohen si grup i qëndrueshëm i trajnuesve dhe ndërmjetësuesve të tjerë në bashkësi. Trajnuesit e rinj, pas mbarimit të punëtorive, jepnin përkrahje mentori gjatë planifikimit dhe realizimit të aksioneve publike, nga ana e nxënësve të shkollave të

mesme, ua bartnin dituritë, përvojat dhe informatat të cilat u nevojiteshin që ta forcojnë aktivizmin, si në shkollat e tyre, ashtu edhe më gjerë në bashkësi nëpërmjet organizimit/lëvizjes joformale rinore.

Profesorët mentorë nga shkollat e mesme, ishin drejtpërdrejt të përfshirë në aktivitetet të cilat realizoheshin në shkolla, i bartnin përvojat e tyre të trajnuesit e rinj në raport me përgatitjen e programit edukativ, qasjes dhe punës me nxënësit, krijimit dhe zbatimit të aksioneve publike dhe të ngjashme. Si mentorë të nxënësve të tyre, ata ua jepnin përkrahjen e plotë për realizimin e ideve të tyre gjatë zbatimit të aksioneve publike dhe në raport me aktivitetet vijuese. Profesorët e inkuadruar edhe më tej do ta lehtësojnë dhe do ta mbikëqyrin në cilësinë e mentorit bashkëpunimin e ndërsjellë të nxënësve. Përvojat e fituara dhe metodologjinë e punës ua bartën kolegëve të tyre nga shkollat e synuara. Aspekti posaçërisht

i rëndësishëm i metodologjisë është vendosja e bashkëpunimit ndërsektorial mes institucioneve arsimore, sektorit civil dhe palëve tjera relevante të prekura ta iniciojnë organizimin joformal, të ndërmarrin nisma dhe aksione të reja me qëllime pozitive në fushën e promovimit dhe zbatimit të vlerave multikulturore dhe realizimin e tyre në jetën e përditshme.

Profesorët, mentorët kishin mundësi që përvojën e tyre nga metodologjia e zbatuar në punë, si praktikë e mirë t'ua bartin shkollave të tyre me qëllim që t'i përfshijnë në planet shkollore dhe programet si për aktivitetet shkollore ashtu edhe për ata jashtëshkollore. Në kontekst të kësaj është edhe botimi i Doracakut "Shkolla për multikulturë" i shtypur në kuadër të programit të IQF ANTIKO, që do të shërbejë si resurs që do t'u ndihmojë mësuesve të grupeve të synuara, por edhe më gjerë, të vazhdojnë në shkollat e tyre në praktikë.

Aksionet publike në bashkësi

Aksionet publike janë inkurajim për të rinjtë që ta shprehin kreativitetin e tyre, të falsin hapur për problemet me të cilat ballafaqohen, t'i tregojnë zgjidhjet dhe alternativat për tejkalimin e tyre. Posaçërisht është e rëndësishme që nëpërmjet llojit të këtillë të aktiviteteve, implementuesit i vendosin në funksion edhe i zhvillojnë aftësitë për lobim, përfaqësim publik, animim të atyre që mendojnë njëjtë dhe/ose krijimit të aleatëve dhe rrjeteve të reja.

Pikërisht për këtë ky aktivitet për të rinjtë paraqiste sfidë të madhe dhe ndoshta pjesa më interesante, më dinamike dhe më ngacmuese e projektit. Ata korniza të aksioneve u pranuan dhe u përshëndetën nga publiku i gjerë dhe mediet, por më e rëndësishme prej të gjithave, kishin mundësi që dituritë dhe shkathtësitë e fituara praktikisht t'i realizojnë dhe thjeshtë me vepra të tregojnë çka dinë dhe munden. Nxënësit e shkollave të mesme të secilës shkollë përgatitën nga një aksion publik me më shumë aktivitete të planifikuara për zgjedhje të problemeve të identifikuara dhe nevojave të të rinjve në shkollën/bashkësinë e tyre, me theks të veçantë në promovimin e vlerave të multikulturës, krijim të hapësirave të përbashkëta për ndërveprim dhe konceptim dhe zbatimin e tyre. U organizuan më shumë se 24 aktivitete në kuadër të 4 planeve të aksionit të cilat



kontribuan drejt rritjes së dukshmërisë së aktivizmit rinor, animimit të të rinjve dhe palëve të tjera të përfshira në bashkësi në raport me çështjet e hapura dhe tabu temat të cilat u trajtuan me aksionet publike. Gjatë aktiviteteve të zbatuara nëpër shkolla, nxënësit e shkollave të mesme treguan se komunikimi pa dhunë, respektimi i dallimeve, toleranca dhe puna e përbashkët për arritjen e qëllimeve pozitive është përkrahur nga bashkësia pa dallim nga ndarjet etnike. Në këtë hapësirë të sigurt, të cilën e krijuan vetë, ndjeheshin shumë më të sigurt, të



dobishëm për shoqërinë dhe të lumtur. Gëzoheshin edhe me entuziazëm e planifikonin dhe zbatonin çdo aktivitet. Nëpërmjet kësaj forme të veprimit ata u forcuan dhe fituan përvojë të madhe. Pas çdo ngjarjeje të organizuar ata ndjeheshin më të fortë dhe më të dobishëm për shoqërinë. Bashkërisht i ndanin përgjegjësitë, sukseset dhe sfidat.

Aktivitetet e realizuar në kuadër të aksioneve publike

Debatet publike

Në kuadër të planeve të aksionit, nga ana e pjesëmarrësve nga të katër shkollat e synuara, u organizuan dhe implementuan katër debatat publike në temën multikultura. Nxënësit e “Zdravko Cvetkovski” nga Shkupi realizuan dy debate publike. Në debatin e parë (26.09.2013) diskutuan në temën “Njohja dhe respekti i kulturës së tjetrit”, qëllimi kryesor i debatit ishte njohja e traditave të ndërsjella, dokeve, kulturës dhe religjionit mes nxënësve. Në debat merrnin pjesë 41 nxënës (nxënës të shkollave të mesme dhe profesorë). Debat i dytë (22.10.2013) ishte me temë “Çka mësuam nga njëri tjetri” dhe kishte të bënte me pyetje të lidhura me praktikumin e përditshëm të multikulturës. Në këtë debat merrnin pjesë 49 pjesëmarrës (nxënës, prindër dhe profesorë) ndërsa ishte përkrahur nga ana e 3 medieeve. Ngjarja u organizua nga ana e nxënësve të shkollave të Tetovës (31.10.2013), “Gjoce Stojčevski” dhe “8 Shtatori” të cilën ata bashkërisht e organizuan dhe diskutuan në temën “Arsimimi ndërkulturor: qasja pozitive ndaj dallimeve”, me qëllim që të theksohet rëndësia dhe roli i aktiviteteve multikulturore të cilat zhvillohen nëpër

shkolla dhe në shoqëri. Në këtë debat merrnin pjesë 30 pjesëmarrës (nxënës, profesorë dhe përfaqësues të vetëqeverisjes lokale) ndërsa u përkrah nga ana e një televizioni lokal.

Nxënësit e “Arseni Jovkov” nga Shkupi, më 31.10.2013 organizuan debat me temën “Multikulturalizmi – a ka ardhmëri?” me qëllim që të shqyrtohen përfitimet dhe implikimet të cilat i sjell multikulturalizmi në vete. Debatuan 40 pjesëmarrës mes të cilëve krahas nxënësve kishte edhe prindër dhe profesorë.

Në këto debate nxënësit shkëmbyen mendime, i dëgjuan edhe mendimet e mysafirëve të ftuar në raport me temat e dhëna (profesorë, prindër, përfaqësues vetëqeverisjes lokale, nxënës), të cilët në mënyrë më të detajuar u njohën me kulturën, traditën dhe zakonet e bashkëpjesëmarrësve të etniteteve të tjera. Ndërtuan qëndrime dhe njëzëri përfunduan se në shoqëritë shumënike siç është e jona, ekzistojnë kushte optimale, mënyra dhe mundësi që ky ndërveprim i ndërsjellë të realizohet në praktikë. Duhet pak më tepër vullnet i mirë, besim i ndërsjellë, tolerancë.



Përgatitja e materialeve promotive dhe informative nga ana e grupeve synuese

Me qëllim që në mënyrë më masive ta promovojnë dhe t'i bëjnë publike mesazhet e tyre dhe të ndikojnë në kultivimin e vlerave të përbashkëta dhe multikulturës, grupet synuese në kuadër të aksioneve publike, dizajnuan dhe përgatitën dy fletushka (një në përpilimin komplet të nxënësve nga “Arseni Jovkov” nga Shkupi, ndërsa tjetra si aktivitet i përbashkët i nxënësve të “Gjoce Stojčevski” dhe “8 Shtatori” nga Tetova). Fletushkat më vonë u shpërndanë në mesin e nxënësve, profesorëve, prindërve dhe palëve të tjera të përfshira nëpërmjet organizimit të prezantimeve publike. Në kuadër të këtij aktiviteti u shtypën dhe u shpërndanë 3000 kopje të fletushkave dhe broshurave.



Realizimi i aksionit ekologjik

Nxënësit e “Gjoce Stojçevski” dhe “8 Shtatori” nga Tetova organizuan aksion ekologjik me qëllim që ta rrisin vetëdijen te popullsia dhe institucionet publike për problemin me ndotjen por edhe si problem të përbashkët i të gjithë njerëzve dhe për të njëjtin duhet bashkërisht të veprojnë pa dallim nga përkatësia etnike. Kopshti shkollor i “8 Shtatori” u pastrua dhe u mbollën lule, ndërsa nxënësit e shkollave të mesme me sukses e bartën mesazhin e tyre për tolerancë shumetnike. Në aksionin ekologjik merrnin pjesë më tepër se 40 pjesëmarrës (nxënës të shkollave të mesme dhe profesorë). Ngjarja u promovua edhe nga ana e dy medieve.

Turnir sportiv shumetnik

Me qëllim që ta përkujtojnë publikun se sporti nuk njihet sipas etnive, nxënësit e “Gjoce Stojçevski” dhe “8 Shtatori” nga Tetova organizuan turnir sportiv në volijboll dhe futboll. Të ndarë në ekipe, të dyja shkollat garuan njëra me tjetrën, nxënëset luajtën ndeshje në volejboll, ndërsa nxënësit një ndeshje futboll. Turniri u ndoq nga një numër i madh i tifozëve nga të dyja shkollat dhe persona të tjerë jashtë shkollave dhe 3 medie. Nxënësit e “Arseni Jovkov” nga Shkupi, e ngritën nismën



Është ngritur nisma për botimin e numrit të parë të gazetës shkollore dygjuhësore në historinë e shkollës të titulluar PRAVEC-DREJTIMI

dhe morën pjesë në përgatitjen dhe botimin e numrit të parë të gazetës në shkollën e tyre. Gazeta është dygjuhësore (maqedonisht dhe shqip) dhe nëpërmjet saj nxënësit dëshirojnë ta promovojnë multikulturën dhe vlerat e përbashkëta të cilat i kultivojnë të gjitha etnitë me tendencë që të botohet edhe më tej dhe të jetë resurs dhe vlerë afatgjate që do ta vazhdojnë gjeneratat tjera. Gazeta “Drejtimi”, u botua në 220 kopje dhe u promovua dhe u shpërnda në prezantimin publik në qendrën Vero. Një pjesë e gazetave u shitën, ndërsa mjetet e mbledhura nga shitja e gazetës u dhuruan në Qendrën Ditore për fëmijë nga rruga. Vazhdim i misionit u bë nëpërmjet organizimit të ngjarjeve kulturore-artistike, me qëllim që të japin kontribut për realizimin e aksioneve me qëllime humanitare.



Aksione me qëllime humanitare dhe pjesëmarrje muzikore

Katër grupet shkollore muzikore nga “Arseni Jovkov” nga Shkupi, më 28.10.2013, mbajtën prezantim humanitar muzikor në hollin e shkollës me qëllim që materialisht t’u ndihmojnë fëmijëve të Qendrës Ditore për fëmijë nga Shuto Orizari. U luajtën rreth 10 këngë në gjuhën maqedonase, shqipe, rome, turke dhe serbe. Nxënësit e kësaj shkolle me këtë aksion porositën se humaniteti nuk njeh etni dhe vetëm me veprim të përbashkët mundemi të kontribuojmë për zhvillim pozitiv në shoqëri dhe t’u ndihmojmë atyre të cilët vërtetë kanë nevojë për ndihmë. Me këtë ngjarje u mblodhën veshje, lojëra dhe



mjete financiare të cilat më vonë u dhanë donacion në Qendrën Ditore për fëmijë të rrugës. Në ngjarje morën pjesë 20 prezantues muzikorë të cilët u përkrahën nga më shumë se 80 vizitorë në ngjarje. Ngjarja u promovua nëpërmjet 3 medieve elektronike dhe rrjeteve sociale.

Prezantim publik për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës

Më 15.11.2013, si aktivitet i përbashkët i nxënësve të shkollave “Arseni Jovkov” dhe “Zdravko Cvetkovski” nga Shkupi, u organizua prezantim muzikor dhe publik në Qendrën Vero nën moton “Multikultura synimi dhe realizimi ynë i përbashkët”. Qëllimi i kësaj ngjarjeje ishte promovimi i vlerave të multikulturës në shoqërinë tonë por edhe shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës. Nxënësit e këtyre dy shkollave shumetnike realizuan program dyorësh në të cilin nëpërmjet leximit të poezisë, ngjarjeve muzikore, kolonisë së artit figurativ, promocionit të gazetës shkollore “PRAVEC-DREJTIMI” dhe ndarjes së fletushkave shpërndanë një pjesë të pasurisë kulturore të etnisë maqedonase, shqiptare, rome, turke dhe serbe. Në prezantim merrnin pjesë më shumë se 75 pjesëmarrës, ndërsa ngjarja u ndoq nga më shumë mysafirë dhe nga ana e publikut më të gjerë duke iu falënderuar përkrahjes së medieve nga ana e 17 medieve.


Organizimi i aksioneve publike për eliminimin e dhunës dhe respektimin e të drejtave të njeriut “16 ditë aktivizëm kundër dhunës familjare dhe gjinore” nën moton: JO edhe për një viktimë!!! STOP dhunës familjare!

Në zbatimin e aktiviteteve të projektit, dimensionin gjinor ishte i përfaqësuar në të gjitha fazat e projektit. Thëks i veçantë në këtë temë u vendos në “Shkollën verore për multikulturë, ku u përpunuan konceptet gjinore dhe gjendja e pabarabartë e gjinive/poleve si në nivel të familjes ashtu edhe në të gjitha sferat tjera të jetës publike, ekonomike, kulturore dhe politike.

Ky edukim gjinor, dha kontribut për vetëdijesimin dhe motivimin e grupeve synuese, pjesë të planeve të tyre të aksionit të planifikojnë aktivitete për zgjidhjen e çështjeve të dhunës familjare, rrënjët e së cilës janë thellë të rrënjosura në gjendjen e pabarabartë dhe ndarjen e pabarabartë të fuqisë mes poleve. Kjo gjendje njëkohësisht paraqet bazë të frytshme për prodhimin e dhunës si në kuadër të shtëpisë, ashtu edhe të shoqërisë. Dhuna familjare gjithashtu ka ndikimin e vet dhe paraqet kërcënim për avancimin e proceseve demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e paqes së qëndrueshme dhe zhvillimin e shoqërive.

Të dhënat të cilat tregojnë për gjendjet alarmante të pranisë së llojeve të ndryshme të dhunës familjare dhe gjinore, ishin shkas që grupet synuese të projektit – studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme si nismë joformale qytetare, aktivizmin e tyre t’ia përkushtojnë sensibilizimit të publikut dhe zgjidhjes së çështjeve nëpërmjet veprimit aktiv në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes. Ata u përcaktuan të organizojnë fushatë për vetëdijesim, informim dhe edukim të nxënësve të shkollave të mesme prej 8 shkollave të mesme, nëpërmjet organizimit të punëtorive me këtë temë dhe organizimit të më shumë prezantimeve publike dhe shpërndarjes së 40.000 kopjeve të materialeve informative, edukative dhe për promocion, si në kuadër të shkollave dhe fakulteteve, ashtu edhe të publikut më të gjerë dhe institucioneve dhe palëve të përfshira. Aksionet u organizuan në kuadër të fushatës Ndërkombëtare: “16 ditë aktivizim kundër dhunës familjare dhe gjinore” (25.11.2013 – 09.12.2013). Nxënësit e të gjitha shkollave të synuara u inkuadruan

në promocionin dhe shënimin e këtij aksioni. Ata drejtuan mesazh deri te publiku për destruktivitetin dhe dëmin e kësaj dukurie e cila nuk është etniko-selektive dhe theksuan se bashkërisht duhet të veprojnë për çrrënjosjen e saj. Nxënësit e dhanë kontributin e tyre me shpërndarjen disaditore të 40.000 materialeve për promocion në këtë temë në institucionet arsimore, vetëqeverisjet lokale, institucionet shtetërore – ministritë, parlament, shitore, banka, posta, stacione autobusi, institucionet shëndetësore, ndërmarrje publike, ambasada, super markete dhe vende të tjera publike.



Punëtori të organizuara kundër dhunës familjare dhe gjinore

Gjatë 16 ditëve u organizuan dhe punëtori në 8 shkolla (nga Shkupi dhe Tetova). Në punëtoritë bëhej fjalë për ngritje të vetëdijes së nxënësve për seriozitetin e këtij problemi. Punëtoritë u mbajtën nga ana e një pjese të PEER trajnuesve të rinj, të cilët i drejtuan nxënësit në simptomat e dhunës familjare, rreziqet ndaj të cilave janë manifestuar viktimat, pasojat ndaj rrethit dhe mënyrat e trajtimit, parandalimi dhe mbrojtja e viktimave. Në punëtori merrnin pjesë mbi 250 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë nga fakultetet pedagogjike dhe fakultetet e shkencave shoqërore të cilët ishin shumë aktive në diskutimet dhe e ndanë shqetësimin e tyre në raport me pyetjet e lidhura me çështjen e dhunës. Si aktivitet i ardhshëm në kuadër të Aksioneve Publike në Bashkësi, nxënësit planifikuan të zbatojnë ngjarje publike me rastin e shënimit të 10 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, me çka do të rrumbullakohen aktivitetet në kuadër të aksioneve publike si produkt dhe aktivitete refleksioni të iniciuara nga ana e grupeve synuese të projektit.

“Ky projekt për ne të rinjtë ka rëndësi të madhe, kemi marrë përvojë të madhe dhe i avancuam shkathtësisë tona në raport me trajtimin e çështjeve të lidhura me promocionin dhe zbatimin e multikulturës. Krahas kësaj fituam shumë miq, u shoqëruam, qeshëm dhe mësuam se nëse dëshiron të jesh i respektuar, duhet të respektosh!” – Edib Hajdarpashiq, nxënës në “Arseni Jovkov” dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në projekt.



Konferenca nacionale¹

Konferenca nacionale është aktiviteti përmbyllës i projektit e cila do të realizohet në 3 dhjetor 2013. Qëllimi i konferencës është vlerësimi i rezultateve të arritura dhe përfitimeve nga aktivitetet e zbatuara të projektit, të fokusuara të japin kontribut në përfaqësimin e politikave dhe pasurimin e teorisë dhe praktikës në fushën e ndërtimit të paqes në bashkësi, nëpërmjet krijimit të hapësirave të përbashkëta për ndërveprim ndëretnik dhe promovim të të rinjve si partnerë seriozë për realizimin e ndryshimeve pozitive. Në konferencë do të diskutohet dhe për temat nga zbatimi i Strategjisë për arsimim të integruar, si edhe për rolin dhe kontributin e sektorit civil në këtë fushë.

Në konferencë janë të ftuar të marrin pjesë mbi 100 pjesëmarrës: përfaqësues të grupeve synuese, institucione arsimore qeveritare, organizata qytetare, organizata ndërkombëtare, bashkëpunëtorë, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, përfaqësues të këshillit të prindërve, profesorë, mentorë, trajnues, institucione arsimore ku zbatohen aktivitetet dhe palë të tjera të përfshira prej të cilave pritet dialog konstruktiv dhe bashkëpunim në raport me avancimin e raporteve multikulturore dhe bashkëpunimit i cili do të japë kontribut në eliminimin e barrierave ekzistuese dhe shfaqja e

dhunës së shpeshtë në bazë etnike mes të rinjve. Produktet të cilat i presim të dalin nga kjo ngjarje janë: rekomandime konkrete, përfundime dhe nisma për përmirësim të aktiviteteve të të rinjve në promovimin dhe zbatimin e bashkëjetesës dhe tolerancës ndëretnike; propozime për zbatim efektiv të Strategjisë për Arsimim të Integruar dhe afrimin e qëndrimeve të subjekteve të ndryshme rreth aspekteve pozitive të Strategjike, të cilat japin rezultate të qëndrueshme në procesin arsimor dhe jashtëarsimor.

Rekomandimet dhe përfundimet, do të dorëzohen deri te institucionet arsimore: këshillat dhe drejtorët e shkollave, këshillat mësimore, këshillat e prindërve, aktivet e klasave, Agjencia për Zhvillimin e Arsimit, Ministria e Arsimit, Njësitë rajonale të Ministrisë së Arsimit, sektorin qytetar dhe mediet. Ata njëkohësisht do të inkorporohen edhe në planet e aksionit të programit të ANTIKO-s “Të rinjtë dhe multikultura”.

Në këtë konferencë zbatojmë edhe një qasje novatore dhe kreative dhe metodologji pune. Respektivisht dhënia e mundësisë së grupeve synuese të projektit të jenë në fokusin e konferencës, respektivisht pjesëmarrës aktivë të saj (si në aspektin e organizimit, ashtu edhe në aspektin e përmbajtjes). Studentët dhe nxënësit e shkollave të

¹ Broshura është shtypur para realizimit të konferencës (në periudhën kur janë mbaruar të gjitha përgatitjet për mbajtjen e saj), për arsye se promovimi i saj është planifikuar të bëhet në vet konferencën.

mesme bashkë me përfaqësuesit e institucioneve të lartpërmendura dhe aktorët, do të kenë hapësirë për pjesëmarrje aktive me prezantimet e tyre për rezultatet e arritura nga aktivitetet e tyre të zbatuara në bashkësi, në kuadër të 4 aksioneve publike me mbi 24 aktivitete të organizuara/zbatuara në bashkësi, të planifikuara, iniciuara dhe zbatuara nga ana e vet grupeve synuese, në kuadër të projektit.

Në konferencë do të prezantohen përvojat e tyre, praktikat e mira dhe sfidat me të cilat u ballafaquan në këtë proces të implementimit. Grupet synuese do të japin analizë vetjake për ndikimin e projektit në forcimin e kapaciteteve të tyre dhe veprimet aktiv në bashkësi, si në nivelin individual ashtu edhe në atë grupor.

Gjithashtu, tema për analizë dhe diskutim do të jetë si ndikoi metodologjia e zbatuar e punës në vetëdijesimin e tyre, motivimin, kreativitetin, aktivizmin dhe gatishmërinë, për pranim të dallimeve, formimit të rrjeteve joformale dhe veprimet të përbashkët me përbërje të përzier etnike në bashkësi. Grupet synuese do të ndajnë leksionet e tyre të mësuara dhe përvojat e mira në raport me përbërësit të cilat e siguruan qëndrueshmërinë e projektit. Informatat kthyesë të fituara nga grupet synuese në pjesën e punës së konferencës dhe analizat e tyre kanë rëndësi shumë të madhe në pasurimin e teorisë dhe praktikës në



fushën e proceseve integruese në bashkësitë/shoqëritë multikulturore, si për IQF ANTIKO, ashtu edhe për organizatat tjera të sektorit qytetar dhe institucioneve relevante të arsimit formal dhe joformal, me qëllim që të njëjtat të inkorporohen në programet dhe planet për veprim.

PRODUKTET, REZULTATET DHE NDIKIMI I PROJEKTIT

-Projekti dha shembull pozitiv, për implementim efektiv të arsimit joformal ndërkulturor në krijimin e **hapësirës së sigurt për ndërveprim ndëretnik**, si proces afatgjatë drejtuar drejt vizionit për shoqëri të drejtë dhe hap të rëndësishëm për paqen e qëndrueshme dhe zhvillim në korniza lokale dhe globale.

-Qasja dhe metodologjia e punës u treguan shumë efektive, e motivuan vetëdijesimin, motivimin, kreativitetin dhe rrjetëzimin dhe aktivizmin qytetar në mesin e të rinjve të më shumë grupeve etnike në shkolla dhe jashtë tyre.

-75% e nxënësve të shkollave të mesme të cilët kaluan nëpër të gjitha fazat e edukimit nëpërmjet mësimi me përvojë, me mentor dhe lidhje të ndërsjellë-rrjetëzim dhe veprim praktik i forcuan kapacitetet dhe përpiluan **4 plane aksioni** dhe zbatuan 24 aktivitete *followup* në bashkësitë. Në realizimin e aksioneve merrnin pjesë studentë dhe nxënës të shkollave të mesme si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, ndërsa profesorët, vetëqeverisja lokale, prindërit, sektori afarist dhe publiku i gjerë si pjesëmarrës indirektë.

-Nëpërmjet aktiviteteve kryesore të projektit 6 ditore TOT u mbajtën 32 punëtori nëpër shkolla, përkrahje e vazhdueshme e mentorit; “Shkolla e multikulturës” me kohëzgjatje 6 ditore, shfaqjet e organizuara publike, koncertet shumetnike, aksionet humanitare dhe ekologjike, ngjarjet shumetnike sportive/turnirë, ngritja e nismës dhe botimi i gazetës së parë shumetnike shkollore nga ana e nxënësve (grupet synuese të projektit dhe mentorët e tyre) me titull PRAVEC-DREJTIMI, fushatat për eliminim të dhunës familjare dhe gjinore patën ndikim dhe ndryshime pozitive në nivel të individëve dhe grupeve në bashkësi.

Në nivel individual – grupi synues – studentët rrjeti i ardhshëm i PEER edukatorëve dhe nxënësit e shkollave të mesme i forcuan kapacitetet e tyre dhe e rritën vetëbesimin e tyre, dijet, shkathtësisë, motivimin, vetëdijen për mundësitë për zhvillim personal dhe aktivizëm si kontribut në ndërtimin e paqes dhe përmirësimin e raporteve ndëretnike në shkollë dhe jashtë saj.

-nëpërmjet përpunimit të temave nga fusha e njohjes së kulturave të tjera, vlerave multikulturore, komunikimit pa dhunë dhe parimeve të tolerancës, pluralizmit, aktivizmit publik etj., ndihmuan ata të tejkalojnë një pjesë të paragjykimëve dhe stereotipave të ndërsjella ekzistuese dhe t'i respektojnë dhe pranojnë dallimet.

Në nivel të grupit: projekti ndikoi në lidhjen edhe rrjetëzimin e nxënësve të shkollave të mesme të grupeve të ndryshme etnike. Ata janë vetorganizuar dhe formuan 4 rrjete joformale të cilat kanë kapacitete dhe mundësi reale për veprim afatgjatë si ekipe shumetnike, të cilat në mënyrë aktive veprojnë në fushën e motivimit të aktivizmit qytetar si mënyrë për zgjedhjen e problemeve në bashkësi.

-ata bashkërisht nëpërmjet dinamikës grupore, përfituan dituri, shkathtësi dhe përvoja të nevojshme për paramendim, planifikim dhe zbatim të nismave/aksioneve/projekteve vullnetare për krijimin e hapësirave

për ndërveprim ndëretnik dhe ngritën nisma dhe dhanë dukshmëri për problemet dhe nevojat e të rinjve. Ata drejtuan mesazhe të shumta deri te të gjithë aktorët të cilët mund të japin kontribut për zgjidhjen e problemeve të të rinjve dhe tejkalimin e tensioneve ndëretnike dhe dhunës të cilat manifestohen në mjedise të caktuara shumetnike.

-Bashkëpunimi i vendosur me sektorin e biznesit, ngjarjet e organizuara kulturore dhe artistike në Qendrën Vero që siguroi shfrytëzim falas të hapësirës publike (Ngjarja publike për shënimin e 16 nëntorit, ditës ndërkombëtare të TOLERANCËS e organizuar nga ana e 2 shkollave shumetnike me pjesëmarrje të grupeve muzikore në më shumë shkolla, organizimi i kolonisë artistike dhe krijimeve letrare – poetike në temat përkatëse të fushë së vlerave multikulturore dhe ndërtimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe paqes në bashkësi).

Falënderim të madh për besimin e treguar dhe
përkrahjen të cilën e dhanë për realizimin e këtij
projekti iu drejtojmë:

- Delegationit të UE-s
- Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- Byrosë për Zhvillimin e Arsimit
- Drejtoreve/drejtorëve të shkollave të mesme: “Arseni Jovkov” dhe “Zdravko Cvetkovski” nga Shkupi dhe “8 Shtatori” dhe “Gjoce Stojčevski” nga Tetova.
- Profesorët dhe profesoreshat – mentorët e shkollave të mesme: “Arseni Jovkov” dhe “Zdravko Cvetkovski” nga Shkupi dhe “8 Shtatori” dhe “Gjoce Stojčevski” nga Tetova.
- Vullnetarëve të Forumit rinor arsimor
- Trajnuesve të ekipit të PEER edukatorëve të rinj
- Nxënësve dhe profesorëve të katër shkollave të përfshira të cilat morën pjesë në realizimin e aksioneve publike



Shkup, Nëntor 2013



Shkup, 11.11.2013



Asociacioni i Organizatave të Kulturës



MULTIKULTURA

Projekti është financuar nga Unioni Evropian. Ky publikim është përpiluar me ndihmën e Unionit Evropian.
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e veçantë e IQF ANTICO dhe Multukultura dhe në asnjë mënyrë
nuk mund të llogaritet se i shpreh qëndrimet Unionit Evropian

